



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, në datën 30 shtator 2019, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Piro	MISHA	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Tiranë dhe Durrës, në datën 01 tetor 2019 dhe shtyrjen e afatit të kalimit në transmetimet numerike në qarkun Vlorë” (**Vendimi nr. 119, datë 30.09.2019**)
2. “Çeljen e procedurës të dhënies së 1 (një) licence private lokale transmetimi audioviziv numerik, për qarkun Elbasan” (**Vendimi nr. 120, datë 30.09.2019**)
3. “Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale, shoqërisë “Radio Sol” sh.p.k., për subjektin audio “Radio Sol”, për të mbuluar me sinjal audio Qarqet Tiranë dhe Durrës”. (**Vendimi nr. 121, datë 30.09.2019**)
4. “Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Tema Tv” sh.p.k., dhe rinovimin e licencës për subjektin audio privat “MCN Radio”. (**Vendimi nr. 122, datë 30.09.2019**)
5. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “House of Arts Radio Televizion” sh.p.k., për subjektin audio privat “House of Arts Radio”. (**Vendimi nr. 123, datë 30.09.2019**)
6. “Kalimin e drejtave të licencës së subjektit person fizik Robert Hoxha tek shoqëria “RVK3” sh.p.k., dhe rinovimin e licencës së subjektit audio privat “Radio Val e Kaltër”. (**Vendimi nr. 124, datë 30.09.2019**)
7. “Rinovimin e licencës së shoqërisë “Radio Klea” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat “Radio Klea”. (**Vendimi nr. 125, datë 30.09.2019**)
8. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Gentian Kusta, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Divjaka”. (**Vendimi nr. 126, datë 30.09.2019**)
9. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “ABCCom” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “ABCCom” dhe ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “3N1 TV”, në “Njësinë administrative Velipojë”. (**Vendimi nr. 127, datë 30.09.2019**)
10. “Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Ergys Çausi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor

- Përrenjas” dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në “Njësinë Administrative Rrajcë”. **(Vendimi nr. 128, datë 30.09.2019)**
11. “Reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Best Cable” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Best Cable” nga “Bashkia Elbasan” në “Njësinë administrative Elbasan” dhe rinovimin e autorizimit”. **(Vendimi nr. 129, datë 30.09.2019)**
 12. “Pajisjen e shoqërisë “RTV ADRIA-MED” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv “TV Adriamed”, për të ofruar shërbim në qarkun Fier”. **(Vendimi nr. 130, datë 30.09.2019)**
 13. “Pajisjen e shoqërisë “Ora” sh.a., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv Ora News”, për të ofruar shërbim në qarkun Fier”. **(Vendimi nr. 131, datë 30.09.2019)**
 14. “Pajisjen e shoqërisë “Intel-Media” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv Jug”, për të ofruar shërbim në qarkun Fier”. **(Vendimi nr. 132, datë 30.09.2019)**
 15. “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 2 datë 31.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Multiscreen” sh.p.k., zëvendësimin dhe rinovimin e licencës për subjektin audioviziv privat “Report Tv”, të ndryshuar”. **(Vendimi nr. 133, datë 30.09.2019)**

Tiranë, 30 shtator 2019

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE